



Analizë e thelluar e qeverisjes vendore në Shqipëri në kontekstin e rekomandimeve të raportit SIGMA për 2024

Autor: Indrit Puteci

Ekspert i Lartë për Qeverisjen Vendore

Mbështetur në realitetin e qeverisjes vendore në Shqipëri dhe në përputhje me rekomandimet e SIGMA, le të analizojmë disa të dhëna, me specifikisht për secilin nga rekomandimet:

1. Delegimi i funksioneve dhe autonomisë për qeverisjen vendore

Procesi i decentralizimit në Shqipëri ka shënuar përparime të rëndësishme. Sipas të dhënave të publikuara nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Z. Arbjan Mazniku, të ardhurat vendore në vitin 2023 arritën në 31 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 271% krahasuar me vitin 2015, kur ato ishin 13.1 miliardë lekë.

Kjo rritje e ndjeshme tregon për një përmirësim të kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV) në mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e burimeve financiare. Megjithatë, për të forcuar më tej autonominë vendore, është e nevojshme që qeveria qendrore të vazhdojë delegimin e funksioneve shtesë tek NJQV-të, duke siguruar njëkohësisht burimet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.

2. Reduktimi i pabarazive në potencialin financiar të qeverisjes vendore

Pavarësisht rritjes së përgjithshme të të ardhurave vendore, ekzistojnë ende pabarazi të theksuara midis bashkive të ndryshme. Buxhetet e bashkive të vogla janë të varura në masën 85% nga grantet dhe transfertat e qeverisë, ndërsa bashkitë më të mëdha e kanë këtë raport më të balancuar, në masën 55%.

Këto pabarazi ndikojnë në aftësinë e bashkive për të ofruar shërbime cilësore dhe për të investuar në projekte zhvillimi. Për të adresuar këtë çështje, është thelbësor forcimi i sistemit të barazimit financiar, duke rishikuar formulën e alokimit të fondeve dhe krijimin e mekanizmave që mbështesin bashkitë me kapacitete më të ulëta financiare.

3. Trajtimi i detyrimeve të papaguara në nivel bashkiak

Detyrimet e papaguara mbeten një sfidë serioze për financat e qeverisjes vendore. Në fund të qershorit 2023, stoku i detyrimeve të prapambetura të bashkive arriti në 6.6 miliardë lekë, me një rritje prej 0.6 miliardë lekësh gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Më poshtë paraqiten detyrimet e papaguara për disa nga bashkitë kryesore:

Detyrimet e papaguara janë në milionë lekë.

Bashkia Tiranë 2,000,

Bashkia Kavajë 777,

Bashkia Vorë 413.

Bashkia Pogradec 273 dhe

Bashkia Lezhë 230.

Këto detyrime përfshijnë shpenzime për investime publike, vendime gjyqësore dhe shpenzime të tjera operative. Për të reduktuar këtë borxh, është e nevojshme që Ministria e Financave të identifikojë shkaqet kryesore të akumulimit të detyrimeve dhe të zbatojë masa për menaxhimin e tyre në mënyrë efektive.

Strategjia për përmbushjen e rekomandimeve të SIGMA

Për të adresuar rekomandimet e SIGMA, mbështetur në analizën e faktorëve që lidhen me to, duhet të ndërtohet një strategji që besoj duhet të mbajë në konsideratë, specifikisht për secilin nga rekomandimet në vijim:

1. Zgjerimi i delegimit të funksioneve dhe autonomisë për qeverisjen vendore

- Hartimi i një plani kombëtar për decentralizimin. Ky plan duhet të përcaktojë qartë funksionet që do të delegohen tek NJQV-të, afatet kohore dhe burimet financiare të nevojshme për zbatimin e tyre.
- Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) që duhet të luajë një rol kyç në koordinimin e procesit të decentralizimit, duke ofruar asistencë teknike dhe ekspertizë në menaxhimin e funksioneve të reja.
- Promovimi i bashkëpunimit ndërbashkiak. Inkurajimi i bashkive për të krijuar partneritete në ofrimin e shërbimeve të përbashkëta, si psh: menaxhimi i mbetjeve, për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot operationale.

2. Forcimi i sistemit të barazimit financiar

- Rishikimi i formulës së alokimit të fondeve. Për të siguruar një shpërndarje më të drejtë të burimeve financiare. Formula aktuale e alokimit të fondeve duhet të rishikohet, duke marrë parasysh nevojat specifike dhe kapacitetet e çdo bashkie.
- Forcimi i të ardhurave të veta. Për të zvogëluar varësinë nga grantet e qeverisë qendrore, duhet të zhvillohen mekanizma për rritjen e të ardhurave të veta të bashkive, përfshirë:
- Përmirësimin e administrimit të taksave dhe tarifave vendore, duke rritur efikasitetin e mbledhjes së tyre.
- Promovimin e investimeve private në nivel vendor për të zgjeruar bazën tatimore.
- Përdorimin më efektiv të pronave publike për gjenerimin e të ardhurave nga mirëmenaxhimi i tyre.

3. Menaxhimi dhe reduktimi i detyrimeve të papaguara nga bashkitë

- Auditim dhe transparencë në financat vendore:
- Çdo bashki duhet të kryejë një auditim të plotë të borxheve të saj dhe të publikojë raportet përkatëse për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.
- Ministria e financave duhet të krijojë një mekanizëm monitorimi të rregullt për gjendjen financiare të bashkive, duke ndihmuar në parandalimin e akumulimit të detyrimeve të reja.
- Hartimi i planit të ristrukturimit financiar.
- Bashkitë me borxhe të larta duhet të hartojnë plane specifike për shlyerjen graduale të detyrimeve të papaguara.
- Qeveria qendrore mund të krijojë një fond të posaçëm për të ndihmuar bashkitë më të prekura, por vetëm nën kushtin e zbatimit të reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar.
- Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik.
- Një nga arsyet kryesore të akumulimit të borxheve është keqmenaxhimi i kontratave publike. Është thelbësore që bashkitë të adoptojnë praktika më të mira të prokurimit për të shmangur shpenzimet e tepërta dhe borxhet afatgjata.

Për zbatimin efektiv të këtyre rekomandimeve, qeveria shqiptare duhet të ndjekë një qasje të integruar që përfshin:

1. Përmirësimin e kapaciteteve administrative të bashkive, duke investuar në trajnime dhe teknologji për menaxhimin më efikas të financave publike.
2. Garantimin e një skeme të drejtë të financimit për të gjitha bashkitë, duke siguruar që edhe njësitë më të vogla të kenë mundësi të barabarta për zhvillim.
3. Adoptimin e praktikave të menaxhimit të shëndetshëm financiar, duke përmirësuar transparencën dhe kontrollin mbi shpenzimet publike.